



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BELSH

Belsh më: 04. 03 .2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: *Blerje produkte ushqimore për Qendrën Sociale “Nderim Brezave”*

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): **Produkte ushqimore të ndryshme-15800000-6**

Vlera e fondit limit: 1 470 683(nje milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa Tvsh

Në mbështetje të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ,neni 21 pika 2, dhe neni 2/c dhe neni 78 i Vendimit Nr.285,datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Belsh ka hartuar proceverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurë e sipërcituar.

Specifikimet Teknike të Përcaktuara në këto Dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-Kriteret e vecanta te kualifikimit janë hartuar nga Komisioni i ngritur me urdher te titullarit Nr .58, date 25.02.2026 me Nr.586protokolli, referuar nenit 76 të pikës (a), nenit 11 të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

Hartimi i dokumenteve të tenderit u bë në përputhje me ligjin Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurim Publik” i ndryshuar me Ligjin nr. 16/2024 për disa shtesa dhe ndryshime, si dhe VKM nr 285 date 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”(I ndryshuar).

*Kriteret e përgjithshme përmbajne administrimin e dokumentacionit, ligjor dhe administrative, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, nëpërputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”i ndryshuar. Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas **Vendimit Nr. 08 Datë 23.09.2024 te miratuara nga APP.***

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 8 të DST, Kriteret e përzgjedhjes dhe kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP i ndryshuar me ligjin Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshimet në ligjin nr. 162/2020” Për Prokurimin Publik”, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” i ndryshuar, citojmë : 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomik bazuar në : b) **gjëndjen ekonomike finaciare**; ... 3. Në lidhje me situatën ekonomike finaciare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim Autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në vecanti që operatorët ekonomik të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomik nuk mund të tejkaloj dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.” **Në nenin “Kërkesat për kapacitet ekonomik-financiar të vendimit të Këshillit të Ministrave me Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” i ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se , vitojmë : “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros**

vjetore të realizuar nga operatori për një periudhë maksimumi deri në 1(tre) vite e fundit finaciare.”
Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave Prokurimit publik” i ndryshuar Përcaktimi I viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në ligjin Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” I ndryshuar, VKM nr.922 datë 29.12.2017 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumentave të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë jo më pak se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës që prokurohet.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të maturuara të parashikuara nga Pushteti Vendor **për vitin 2025** sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar); prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës.

Shënim: Në procedurat e prokurimit me një fazë,” përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, nenin 77 pika 3 e LPP, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” I ndryshuar. Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2024 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret që janë në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon **vërtetime** të lëshuara a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga

një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen **vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të **deklaruar në organet tatimore**, ku shënohen **datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara**.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të **deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara**.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55 pika 4/b), të VKM NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar .Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojëshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit , që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. *Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore së sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet.Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjëndjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët , nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme. Përvoja e mëparshme është një element i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomik mbi bazë të vlerave të kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitet për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM NR.285, DATË 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një Bashkim operatorësh ekonomik sipas pikës 2 dhe 3 , të nenit 14 të LPP-së ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhje, edhe gjatë zbatimit të kontratës.Në duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar nëpërmjet palëve. Ne nenin 55 “PROCEDURË E HAPUR E THJESHTUAR” pika 4/b të vendimit të këshillit të ministrave me NR.285, DATË 19.05.2021“Për miratimin e rregullave prokurimit publik” I ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë :4. Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm .Lidhur me kërkesat për përvojat e ngjashme , vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara do të jetë: b)Për kontratat e mallërave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është e realizuar gjatë tri viteve të fundit , nga data e shpalles së njoftimit të kontratës. Njësia e Prokurimit nga interpretimi literal i kësaj norme juridike vlerëson se edhe këto kriteret janë të detyrueshme për tu vendosur në DST . Fjala “kërkon” nënkupton se këto kriteret janë detyruese, dhe si të tilla duhet të vendosen në DST-në e Prokurimit me objektin e mësipërme.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme

Ne rast të BOE Pika 1/a plotësohet nga anëtar i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Shenim: *Per punet e ngjashme te realizuara si BOE krahas dokumenteve te mesiperme duhet te paraqitet edhe kontrata e bashkepunimit ku përcaktohet ndarja e zerave te punimeve ndermjet paleve, ndersa per*

punet e ngjashme te realizuara si nenkontraktor duhet te paraqitet edhe kontrata e nenkontraktimit ku percaktohen zerat e punimeve dhe miratimi i autoritetit kontraktor/investitorit.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë çertifikata cilësie në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Çertifikata e kërkuar është si më poshtë:

- ISO 22000:2018 (Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore) ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar në piken 1, të nenit 44, të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-se nr.10181 prot, date 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Kjo kërkesë dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë, sigurisë ushqimore. Standarti ISO 22000:2018 (Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore) ose ekuivalente percakton kërkesa për një sistem të menaxhimit të sigurisë ushqimore duke mbuluar të gjithë zinxhirin ushqimor (nga furnizimi deri në shpërndarje).

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë Liçencë, kategoria II.1.A.1 “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz” të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Shenim: Nuk lejohet përdorimi i licenses se një operatori tjetër ekonomik (Rekomandim i përbashkët i APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 40, pika 5, shkronja a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe bazuar në Rekomandimin e përbashkët të APP-se dhe AKU-së nr.10181 prot, datë 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”. Paraqitja e liçences është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën e sigurisë ushqimore dhe mbrojtjes së konsumatorit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga administratori ose përfaqësuesi ligjor, me anë të së cilës:

- Merr përsipër që furnizimi me produkte ushqimore do të kryhet pranë AK , sipas kërkesave dhe nevojave të këtij të fundit, brenda afateve të përcaktuara në kontratë.
- Të garantojë që produktet ushqimore do të jenë të freskëta dhe brenda afatit të përdorimit, si dhe të ruajtura dhe transportuara në përputhje me kushtet higjieno-sanitare dhe temperaturat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë

kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Kjo kërkesë është vendosur me qëllim eliminimin e kostos së shtuar për Autoritetin Kontraktor sa i takon transportit dhe shkarkimit të mallrave objekt prokurimi në magazinën e Bashkise Belsh, dhe për këtë është kërkuar që Operatori ekonomik ofertues të paraqesë një deklaratë nëpërmjet të cilës të marrë përsipër me kostot e veta realizimin e këtyre proceseve. Produkte ushqimore përbëjnë mallra të ndjeshme, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e konsumatorëve. Për këtë arsye, garantimi i freskisë dhe i respektimit të afatit të përdorimit është thelbësor për realizimin korrekt të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga : Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe perlllogaritjen e fondit limit, kritereve të vecanta” mbështetur ne VKM nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, në varësi të objektit të kontratës përcjell me procesverbalin Nr.587Prot., datë 25.02.2026 nga Komisioni i hartimit të specifikimeve teknike krijuar me urdhërin Nr.586Prot, datë 25.02.2026, Specifikimet e produkteve janë marre nga katalogu “Blerje artikuj ushqimore” 2025 nga OPERTATORI BLERJEVE PERQENDRUARA.

Specifikimet teknike të hartuara për mallra objekt prokurimi, përshkruajnë elementet me të rendesishëm përbërës , që garantojnë cilësinë e kërkuar në përputhje me parashikimet e nenit 4 , pika 38/b dhe nenit 36, të LPP i ndryshuar si dhe nenit 40 pika 2 e VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per miratimin e rregullave prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar cdo kërkesë funksionale ose performance, dhe cdo standard të kërkuar, referuar kërkesave dhe standardeve ndërkombëtare.

KOMISIONI SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

NJËSIA E PROKURIMIT:
